AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

BULETIN MUJOR

TETOR 2026



PËRMBAJTJA

- AKSK forcon partneritetin me SHBA-në për sigurinë kibernetike
- Shqipëria në European Cyber Security Challenge 2026
- AKSK dhe Hybrid CoE, bashkëpunim për përballimin e kërcënimeve hibride
- Tetori, Muaji i Ndërgjegjësimit për Sigurinë Kibernetike
- AKSK promovon sigurinë digjitale te fëmijët dhe të rinjtë

AKSK forcon partneritetin me SHBA-në për sigurinë kibernetike

Forcimi i kapaciteteve kombëtare dhe mbrojtja e infrastrukturave kritike ishin në fokus të takimeve të delegacionit të AKSK-së, të kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Bledar Kazia, me përfaqësues të Departamentit të Shtetit, CISA-s dhe MITRE-s në Washington, D.C. Palët diskutuan mundësitë për thellimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e angazhimeve të përbashkëta për përballimin e sfidave të sigurisë kibernetike.

Vëmendje e veçantë iu kushtua zgjerimit të bashkëpunimit operacional, shkëmbimit të informacionit mbi kërcënimet dhe koordinimit në reagimin ndaj incidenteve. Diskutimet përfshinë gjithashtu zhvillimin e kapaciteteve përmes trajnimeve të specializuara, shkëmbimit të ekspertizës dhe nismave të përbashkëta, në funksion të një mbrojtjeje më të qëndrueshme për institucionet dhe shërbimet digjitale të vendit.



Shqipëria në European Cyber Security Challenge 2026

Ekipi shqiptar, nën koordinimin e AKSK-së, përfaqësoi vendin në European Cyber Security Challenge 2026, të zhvilluar më 12–16 tetor në Bochum, Gjermani. Përballë ekipeve nga 42 vende, të rinjtë shqiptarë testuan aftësitë e tyre në sfida praktike të sigurisë kibernetike, në formatet Jeopardy CTF dhe Attack–Defense, që kërkojnë njohuri teknike, mendim analitik dhe bashkëpunim në ekip.

Me mbështetjen e ekspertëve dhe trajnerëve të AKSK-së, pjesëmarrja në këtë kompeticion u dha të rinjve mundësinë të zhvillojnë aftësitë, të shkëmbejnë përvoja me bashkëmoshatarë nga vende të ndryshme dhe të krijojnë lidhje me komunitetin ndërkombëtar të sigurisë kibernetike. Angazhimi në ECSC është pjesë e përpjekjeve të AKSK-së për të identifikuar dhe mbështetur talentet e reja, duke kontribuar në përgatitjen e brezit të ardhshëm të profesionistëve të fushës.



AKSK dhe Hybrid CoE, bashkëpunim për përballimin e kërcënimeve hibride

Kërcënimet hibride, dezinformimi dhe ndërhyrjet e huaja ishin në fokus të workshop-it të organizuar më 5 tetor në Tiranë nga AKSK në bashkëpunim me Qendrën Evropiane të Ekselencës për Kundërvënien ndaj Kërcënimeve Hibride (Hybrid CoE). Aktiviteti trajtoi sfidat që këto kërcënime paraqesin për institucionet dhe shoqërinë, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit për identifikimin dhe përballimin e tyre.


Drejtori i Përgjithshëm i AKSK-së, Bledar Kazia, theksoi rreziqet që lidhen me përdorimin e inteligjencës artificiale për manipulimin e informacionit dhe cenimin e besimit publik. Diskutimet vunë në qendër forcimin e kapaciteteve institucionale, shkëmbimin e ekspertizës dhe rritjen e ndërgjegjësimit për të ndërtuar qëndrueshmëri ndaj kërcënimeve hibride.

Tetori, Muaji i Ndërgjegjësimit për Sigurinë Kibernetike

Gjatë tetorit, AKSK i kushtoi vëmendje të veçantë ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe institucioneve për rreziqet në hapësirën digjitale dhe mënyrat e mbrojtjes ndaj tyre. Përmes materialeve informuese, aktiviteteve edukuese dhe komunikimit në kanalet zyrtare, në fokus ishin njohja e mashtrimeve online, mbrojtja e të dhënave personale dhe përdorimi i sigurt i teknologjisë.

Mesazhet e muajit nxitën qytetarët të verifikojnë informacionin, të tregojnë kujdes ndaj komunikimeve të dyshimta dhe të raportojnë kërcënimet kibernetike. Vëmendje iu kushtua edhe sigurisë së fëmijëve dhe të rinjve online, duke theksuar rolin e përbashkët të familjes, shkollës dhe institucioneve në zhvillimin e zakoneve të sigurta digjitale.





AKSK promovon sigurinë digjitale te fëmijët dhe të rinjtë

Gjatë tetorit, AKSK vijoi ndërgjegjësimin për përdorimin e sigurt të internetit, përmes aktiviteteve në shkolla dhe materialeve informuese për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve online. Në këtë kuadër, më 8 tetor u zhvillua një aktivitet në gjimnazin “Petro Nini Luarasi”, duke e sjellë edukimin për sigurinë kibernetike më pranë nxënësve.

Komunikimi ndërgjegjësues vuri theksin te kujdesi ndaj grupeve dhe ndërveprimeve online, mbrojtja e të dhënave personale dhe raportimi i përmbajtjeve të dëmshme. Mesazhet nënvizuan rëndësinë e bashkëpunimit mes shkollës, familjes dhe institucioneve për t’i ndihmuar të rinjtë të njohin rreziqet dhe të zhvillojnë zakone të sigurta në mjedisin digjital.